

VENDIM
Nr. 109, datë 19.5.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“DANSKE COMMODITIES ALBANIA” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”; pika 5, pika 1, germa “e”; të nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 668/4 prot., datë 13.5.2022, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Danske Commodities Albania’ sh.p.k., me nr. 374, seria T12/T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 4.7.2017”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Danske Commodities Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 477/1 prot., datë 4.5.2022, ka paraqitur aplikimin për rinovimin e licencës nr. 374, seria T12/T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 16, pika 1, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë. Në zbatim të këtij neni shoqëria duhet ta paraqesë aplikimin brenda datës 4.5.2022. Sikurse konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj më datë 4.5.2022, pra brenda afatit të parashikuar sipas këtij neni.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal, si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim - neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “e”, plotësuar;

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gjerat “b” dhe “d”, plotësuar;

- Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8, gjerat: “a”, “b” dhe “d”, plotësuar;

- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).

Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për administratorin e saj, në rast se ai rezulton rezident në Shqipëri;

Dokumentacionin financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore).

Shoqëria duhet të informojë se si ka vijuar procesi i apelimit administrativ dhe i shlyerjes së detyrimeve ndaj institucionit tatimor;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione, të tjera, etj.).

Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentacion mbështetës financiar në të cilin shprehen qartë vlerat monetare që do t’i shërbejnë kësaj veprimtarie;

Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8:

- germa “b” (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj).

Shoqëria duhet të përcjellë në ERE kapitalin financiar për ushtrimin e veprimtarisë, të shoqëruar me dokumentacion mbështetës.

- Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet për pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., me nr. 374, seria T12/T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 4.7.2017.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti